

Prezantimi dhe njohja me Sportin :

Organizimi i "Javës Olimpike"



Kohëzgjatja: Nga një në disa muaj

Grupi i synuar: Fëmijë dhe adoleshentë nga moshë 9 deri 15 vjeç

Qëllimi i Javës Olimpike: Ngritja e vetëdijes dhe frymës sportive tek fëmijët duke u ofruar atyre mundësinë për të praktikuar sporte të ndryshme falas me ndihmën dhe këshillat e profesionistëve.

Burimet njerëzore të nevojshme:

- Ekip i dedikuar për të organizuar aktivitetin (1-2 persona, në 6 deri 12 muaj përgatitje në varësi të aktivitetit).
- Grup vullnetarësh për të drejtuar pjesën operacionale të aktivitetit (duke ndihmuar instruktorët e klubit dhe shkollave, me akreditimin e fëmijëve, llogaritjen e fëmijëve që do të marrin pjesë në aktivitete, sigurinë dhe monitorimin e fëmijëve), vendosja e dy deri në tre vullnetarëve për çdo aktivitet.
- Grup instruktorësh vullnetarë për çdo sport të vënë në dispozicion.
- Mbështetje logjistike për montimin dhe çmontimin e pajisjeve nga organizatorët vëndas.
- Ekip për sigurimin dhe mbikëqyrjen e pajisjeve gjatë natës.

Pajisje dhe burime të tjera të nevojshme:

- Pajisjet sportive duhet të sigurohen nga klubet apo shkollat.
- Ndihma e parë.
- Tenda, tavolina, stola etj (në varësi të nevojave) – të vihen në dispozicion nga organizatorët ose autoritetet e qytetit .
- Radiolidhje apo sisteme të tjera komunikimi për stafin.
- Ushqimi për vullnetarëve dhe organizatorët si shenjë falenderimi.

Përshkrim

Fëmijët dhe të rinjtë marrin pjesë në disa lojëra, sporte dhe disiplina Olimpike ose jo Olimpike, të ofruara nga klubet sportive dhe organizatorët. Çdo aktivitet zgjat rreth 30 minuta, ku fëmijët mund të përzgjedhin aktivitetet ku do të marrin pjesë brenda grupit të lojërave të ofruara gjatë javës Olimpike.

¹ Bazuar në përvojën e mbi 30 javëve Olimpike organizuar çdo vit nga Muzeu Olimpik në Lozanë (pjesëmarrja e rreth 3,000 fëmijëve në vit).

Lista e plotë

Përshtatur në bazë të përvojës së organizimit të Javës Olimpikë në Muzeun Olimpik në Lozanë :

6 deri 12 muaj më përpara datës së aktivitetit :

- Kontaktimi me klubet sportive lokale duke i ftuar ata të marrin pjesë në Javën Olimpikë, dhe duke vënë në dispozicion pajisjet dhe instruktorët gjatë kohëzgjatjes së aktivitetit.
- Përgatitja dhe dërgimi i " detajeve të aktiviteve " (shih shtojcën I).
- Kontaktimi me autoritetet lokale për të siguruar autorizimet, rezervimin e hapësirave publike, mbylljen e rrugëve, disponueshmërinë e pajisjeve, etj.
- Gjetja dhe regjistrimi i vullnetarëve.
- Kontaktimi me partnerët e marketingut, sponsorat, etj.
- Përgatitja dhe printimi i formularëve të regjistrimit për pjesëmarrësit. Prindërit duhet t'i nënshkruajnë ato ! (Shih shtojcën II .)
- Porositja e Banerave, posterave dhe fletëpalosjeve për promovimin e aktivitetit dhe partnerëve.
- Porositja e veshjeve, uniformave për stafin dhe vullnetarët.
- Planifikimi për organizimin dhe servirjen e ushqimit për të gjithë.

3 muaj më përpara:

- Promovimi i javës Olimpikë dhe regjistrimi i pjesëmarrësve.
- Rrikontaktimi me klubet sportive, duke u siguruar që të gjitha marrëveshjet të jenë të nënshkruara (aspektet logjistike).
- Planifikimi i menaxhimit (kontaktet, përgjegjësitë, plani i veprimit, etj)
- Organizimi i ndihmës së parë.
- Organizimi i mbikqyrjes së objekteve dhe paisjeve gjatë natës.
- Planifikimi i një mbrëmjeje festive falenderimi për pjesëmarrësit dhe vullnetarët ; ftesat.

1 muaj më përpara:

- Organizoni një takim koordinues me pjesëmarrësit.
- Dërgimi i vendndodhjes përfundimtare dhe informacioneve të tjera praktike te pjesëmarrësit.
- Ndarja në grupe e vullnetarëve (caktimin e roleve dhe vendeve – duke marrë parasysh, nëse është e mundur, dëshirat dhe kompetencat e tyre)
- Punësimi i një fotografi (Nëse ju doni të fotografoni fëmijët gjatë aktivitetit, por kjo duhet cituar në formularin e regjistrimit që prindërit të nënshkruajnë, shihni shtojcë II)

Një ditë më përpara : Fillimi

- Informimi i vullnetarëve dhe pjesëmarrësve. Është e rëndësishme që të gjithë të dinë se **CFARE** dhe **SI** duhet të bëjnë (Caktoni saktë vendndodhjen e aktivitetit).

Gjatë Javës Olimpikë:

- Organizoni takime të përditshme me vullnetarët dhe organizatorët.
- Planifikimi dhe organizimi me detaje i çmontimit (planifikoni mjaftueshëm njerëz, japni udhëzime shumë të sakta mbi çfarë duhet bërë dhe si. Mos hezitoni të siguronit fotot ose planet për heqjen e pajisjeve).

2 javë më vonë:

- Mbajtja e një takimi me organizatorët dhe autoritetet lokale.
- Përgatitja dhe dërgimi i letrave të falënderimit për të gjithë partnerët (klubet, shkollat, autoritetet lokale, partnerët e marketingut, etj)
- Organizimi i një darke falenderuse për të gjithë.

Nëse keni ndonjë pyetje ose keni nevojë për ndihmë, mos ngurroni të kontaktoni stafin e KOKSH me adresen::

secretariat@nocalbania.org.al

SHTOJCA I – Detajet e aktivitetit (Model)

"Java Olimpike "

Datë:	<p>Ju lutemi riktheni këtë dokument pasi ta keni plotësuar (me date) dhe firmosur (emri dhe adresa) Një kopje e nënshkruar nga ne, do t'ju kthehet në një datë të mëvonshme.</p>					
Qëllimi i Javës Olimpike	<p>Ngritja e vetëdijes dhe frymës sportive tek fëmijët duke u ofruar atyre mundësinë për të praktikuar sporte të ndryshme falas me ndihmën dhe këshillat e profesionistëve.</p>					
Kontakt	<p><i>Emri i Koordinatorit dhe kontakti</i></p>					
Sporti / Aktiviteti	<p><i>Emri i Sportit :</i></p>			<p><i>Adresa :</i></p>		
Detajet e kontaktit	<p><i>Emri i Klubit / shkollës :</i></p>			<p><i>Adresa postare e klubit / shkollës :</i></p>		
	<p><i>Emri i drejtuesit të pranishëm në aktivitet :</i></p>			<p>.....</p>		
	<p><i>Telefon :</i></p>			<p><i>Adresa e-mailit:</i></p>		
Instrukturët	Dita 1	Dita 2	Dita 3	Dita 4	Dita 5	Dita 6
Vullnetarë për pritjen e organizimin e aktivitetit	Dita 1	Dita 2	Dita 3	Dita 4	Dita 5	Dita 6
Data	<p><i>Specifikoni datat dhe kohën e aktivitetit :</i></p>					
Vëndi	<p><i>Specifikoni datën dhe vëndin e aktivitetit (dita 1)</i></p>					
Informimi	<p><i>Data / koha / vendi : 1 person përgjegjës për shpërndarjen e materialeve dhe uniformave.</i></p>					
	<p><i>Përcaktoni kohën dhe vëndin</i></p>					
Termet e references për klubet / shkollat pjesëmarrëse	<ol style="list-style-type: none"> Organizoni aktivitetin gjatë Javës Olimpike në përputhje me kohën dhe datat e mësipërme. Zgjidhni instruktorë të kualifikuar dhe të motivuar për aktivitetet me të rinjtë (të moshës 9 deri në 15). Është përgjegjësi e organizatorëve për të siguruar nëse instruktorët kanë ndjekur trajnimin bazë për këtë aktivitet. Planifikoni një numër të mjaftueshëm instruktorësh që të jenë në gjendje për të menaxhuar periudhat e pikut. Siguroni pajisjet e nevojshme për veprimtarinë dhe montimin e tyre. Të kihet parasysh hapja dhe fillimi i aktivitetit në datën dhe orën fikse të përcaktuar. Mbani shënime të përditëshme të numrit të fëmijëve pjesëmarrës në aktivitetin tuaj, nëse ju nuk keni vullnetarë. Organizatorët dhe instruktorët e aktiviteti janë përgjegjëse për shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve dhe të rinjve. Është e rëndësishme marrja e të gjitha masave të sigurisë përgjatë aktivitetit. Organizatorët janë përgjegjës në mënyrë të veçantë për mbikëqyrjen e fëmijëve dhe të rinjve pjesëmarrës në aktivitet. 					
Përshkrimi i aktiviteti të ofruar nga klubi / shkolla						
Pajisje të ofruara nga organizatorët						
Kërkesa për pasjisje të vecanta	<p><i>Psh. Tenda : jo . Tabela : jo Monitore : po Karrike: po</i></p>					
Komente						

Data dhe nënshkrimi i drejtuesit të aktivitetit (klubi/shkolla)	Data dhe nënshkrimi i organizatorit te Javës Olimpike (KOKSH)

SHTOJCA II - Broshura dhe formulari i regjistrimit "Java Olimpikë ": Broshura dhe formulari i regjistrimit

Formulari, Broshura e regjistrimit duhet të përmbajë elementët e mëposhtme të përshtatura,

1. Teksti prezantimit

2. Lista e Sporteve dhe aktiviteteve që ofrohen

3. Datat dhe ora

4. Formulari i regjistrimit (me nënshkrimin e detyrueshëm të përfaqësuesit ligjor)

Mbiemri _____ Emri _____

Viti i Lindjes _____ Numër Telefoni _____

Adresë _____

Qytetit _____ Qarku _____

Gjinia (Mashkull/Femer) _____ E-mail _____

Nënshkrimi i prindit ose kujdestarit ligjor (i detyrueshëm) _____

Formulari duhet të kthehet në datë _____ Adresë/e-mail _____

Informacion _____ Numër Telefoni/e-mail _____

5. Informacione praktike, shëmbull që mund të përshtatet nga ju.

Informacion

Aktiviteti duhet të zhvillohet nën të gjithë përgjegjësinë e prindërve. Sigurimi është përgjegjësi e secilit pjesëmarrës. Organizatorët nuk mbajnë përgjegjësi në rast të ndonjë aksidenti, dëmtimi ose vjedhje.

Ushqimi / Katering

Informacion mbi mundësinë e ofrimit të ushqimit për fëmijët.

Hidratimi

Këshillohet pirja e lëngjeve në mënyrë të rregullt për të shmangur dehidratimin gjatë aktivitetit. Mos harroni të merrni ujë me vete.

Të drejtat e Fotografimit (teksti mund të përshtatet në përputhje me ligjin në fuqi).

Prindërit duhet të jenë në djeni të faktit se fëmijet do të fotografohen gjatë aktivitetit të Javës Olimpikë, dhe ata duhet të japin miratimin e tyre për mundësinë e kryerjes dhe publikimit të fotove.

Informacione

Emri. _____ Numri i telefonit dhe adresën e e-mailit të personit kontaktit.

6. Promovimi i sponsorëve dhe falenderime

- Logot e sponsorëve
- Falenderimi i të gjithë pjesëmarrësve, partnerëve dhe vullnetarëve